



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 16.9.2015, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Agim Aliu dhe Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zef Prendrecaj, drejtor ZPD dhe Hasime Osmani, inspektore e lartë gjyqësore, Kaltrina Ahmeti – GLPS, Fitore Hajdini – ZPRK, Blerta Bejtullahu-EUSR/EU, Basri Berisha – IAP, Besmir Pokollari – Instituti i CHAT, Arton Demhasaj – Çohu, Ardian Bajraktari – MD, Fjolla Uka – Kdi, Gresa Ramadani – vizitor, Valdete Berisha – Kosova Sot, Lejla Selimi – OSBE, Alma Tafarshiku – EULEX, Drilon Asllani-Radio Dukagjini, Dibran Istrefi – Klan Kosova dhe Gentiana Dushi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.6.2015;
3. Njoftim me shkresën e dërguar nga ZPD-ja;
4. Diskutim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik;
5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;

6. Shpallja e konkursit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Kuvendi;
7. Shqyrtimi i planit të punës së komisionit për sesionin vjeshtor;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja propozoi që pika shtatë të hiqet nga rendi i ditës pasi, siç tha ajo , është i ngarkuar sot rendi i ditës.

Armend Zemaj, tha se lidhur me pikën e gjashtë, është formuar një grup punues për përgatitjen e një drafti për Komisionin dhe propozoi që para se të vendosin si Komision për shpallje të konkursit , të takohet grupi punues që ta kenë një draft nga ky grup.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.6.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.6.2015, pa vërejtje.

3. Njoftim me shkresën e dërguar nga ZPD-ja;

Kryetarja përshëndeti të pranishmit dhe i njoftoi me shkresën e dërguar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor. Ajo sqaroi se fjala është për dy ligjet tashmë të miratuara, Ligjin Nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin Nr. 05/L-035, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ju e dini që janë pikërisht këto ligje në të cilat kemi punuar në procedura të përshpejtuara, pra kemi pas 5 ditë punë në dispozicion sepse ka qenë pakojë për liberalizimin e vizave dhe është e natyrshme që tani vërehen lëshime. Në shkresë janë dhënë sqarime pse këto dy ligje paraqesin pengesë në punën e ZPD-së. Ftoj z. Zef Prendrecaj që ta marrë fjalën dhe ta arsyetojë shkresën, tha Albulena Haxhiu .

Zef Prendrecaj – ZPD- Falënderoj komisionin për ftesën dhe mundësinë që, si zyrë, të paraqesim shqetësimet lidhur me dy ligjet e theksuara. Ashtu siç e përmendi edhe kryetarja, këto dy ligje janë shqyrtuar me procedura të përshpejtuara dhe ndryshimet e këtyre dy ligjeve prekin drejtpërdrejt punën e ZPD-së. Për ata që nuk e din ZPD-ja ka mandat të hetojë sjelljen e pahijshme që kryhet nga ana e gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë dhe prokurorëve në nivel të Kosovës në të gjitha instancat. Këto dy ligje përcaktojnë afatet dhe ne si zyrë nuk jemi kundër përcaktimit të afateve lidhur me parashkrimin e rasteve disiplinore, por këto afate që janë përcaktuar me këtë ligj janë shumë të shkurta dhe na pamundësojnë neve si zyrë të kryejmë punët tona për shkak se kemi numër të vogël të inspektorëve, edhe pse çdo vit kemi kërkuar që ky numër të rritet, por institucionet kompetente nuk kanë lejuar rritjen e stafit.

Shqetësuese në këtë situatë është fakti se ne gjatë gjithë ditës pranojmë parashtresa nga më të ndryshmet, për sjelljen e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe tani me këto dy ligje ne nuk mund të veprojmë. Ai mori shembuj nga praktika që shkurtimi afateve do t'ju pamundësojë që ta kryejnë punën si zyrë dhe kjo do të lirojë ata gjyqtarë dhe prokurorë, për të cilët dyshohet sa kanë kryer

ndonjë shkelje të dispozitave ligjore. Ne pranojmë raste nga qytetarët por ne hetojmë edhe rastet sipas detyrës zyrtare. Ne zakonisht kërkojmë nga gjykatat dhe prokuroritë të dimë se sa raste janë parashkruar brenda një viti. Ndodhë që, sot, të pranojmë një informatë që një prokuror ka lejuar një rast të krimit të organizuar apo të shpërdorimit të detyrës zyrtare të parashkruhet para tri viteve. Dhe nëse i referohemi këtyre dy ligjeve, ne nuk mundemi me ndërmarrë asnjë veprim sepse këto ligje na pamundësojnë dhe nëse ne si zyrë nuk mund të veprojmë, atëherë as komisionet dhe as këshillat nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim sa i përket sjelljes jo të mirë. Nëse integriteti i një gjyqtari apo prokurori vihet në pikëpyetje, edhe ashtu besueshmëria e qytetarëve në sistemin e drejtësisë është jo, ata mbesin pa u hetuar përmes komisionit dhe këshillit sipas dispozitave të këtyre ligjeve. Andaj, kërkesa jonë është që të gjendet një zgjidhje që këto dispozita ligjore të ndryshohen dhe plotësohen ose të fshihen përkohësisht deri në një zgjidhje adekuate. Këto dy ligje nuk përmbajnë dispozita kalimtare dhe as dispozita më të favorshme, si të veprojmë me rastet që i kemi pas në procedurë para se të hynë në fuqi këtë dy ligje. Nuk është paraparë as nxjerrja e ndonjë akti nënligjor që mund të specifikojnë se çka duhet bërë për rastet specifike.

Po e marr një shembull, nëse një qytetar ankohet se lënda e tij është kontest nga marrëdhënia e punës e që ka përparësi ligjore në vendosje sipas ligjit po i vonohet prej 2002 – 2003, neve na pamundësohet të veprojmë po që se kanë kaluar më tepër se dy vite sepse Ligjet na pamundësojnë. Çka nëse është duke vazhduar në mënyrë permanente sjellja ose veprimi, çka duhet të ndërmerret, pra duhet të kemi akte nënligjore që i shpjegojnë sepse këtu kemi të bëjmë me çështje të ndjeshme, me procedura disiplinore të prokurorëve dhe gjyqtarëve, prej nivelit më të lartë deri te ai më i ultë në sistemin prokurorial dhe gjyqësor në Kosovë. Pra, nuk kemi të bëjmë me procedura se po e hetojmë dikë, që nuk merret vesh në çështje të hetimeve apo të legjislacionit, por kemi të bëjmë me nivele të larta dhe aty gjendet mundësia në baze të këtyre dy dispozitave dhe dy ligjeve mund ti shmangen procedurave të komisionit dhe të këshillit. Kërkesa jonë është që të gjejmë një modalitete se si të rregullohen këto dy dispozita. Nuk kemi asgjë kundër që të ketë parashkrim të rasteve, sepse edhe veprat penale parashkruhen, edhe rastet më të rënda të veprave penale parashkruhen dhe duhet të ketë parashkrim edhe për raste disiplinore, por afatet duhet të jenë më të gjata, në mënyrë që jo për situatat më të vështira të ketë parashkrim dhe të amnistohen.

Donika Kadaj Bujupi - Pyetja ime ndërlidhet me informatat e fundit që kanë dalë në media, që kryesisht kanë ardhur nga Komuna e Prizrenit, ku kemi të bëjmë me shumë skandale të prokurorëve dhe gjyqtarëve, ku kanë nxjerr njerëz edhe në protesta dhe janë bërë të njohura edhe përmes emisionit televiziv “Drejtësia në Kosovë”. Pra a keni marrë ndonjë masë ndaj këtyre rasteve, apo sa jeni ju aktiv në ndërmarrjen e masave disiplinore, apo gjithmonë duhet të pritët deri sa të lajmërohen këto raste ?

Kryetarja – Sugjeroi z. Prendrecaj që ti shënojë pyetjet sepse ne fund do ta këtë mundësinë prapë të marrë fjalën dhe të përgjigjet në këto pyetje dhe shqetësimet e anëtareve të Komisionit.

Armend Zemaj theksoi se ajo çka u tha nga deputetja Donika Kadaj, është më e rëndësishme se kërkesa që sot po e diskutojmë. Është një temë e gjerë, ku komisioni jo vetëm me ju por edhe me njerëz të tjerë që janë përgjegjës të Këshillit Gjyqësor, duhet të bisedojmë dhe së bashku, të kontribuojmë që të përmirësojmë efikasitetin e sistemit të drejtësisë në vend.

Zemaj tha se kam dëgjuar gjatë kësaj kohe të plotësimit- ndryshimeve të këtyre ligjeve që ka pasur kualifikime të tilla, që Komisioni për Legjislacion në mënyrë klandestine ka përvjedhur një amendament që i pastron gjyqtarët që përballen me drejtuesin.

Këtu janë prezent edhe kolegët që kanë punuar në këtë ligj dhe për hir të opinionit dua të sqarojë se kjo nuk është e vërtetë, është një kualifikim i rëndë dhe ka të bëjë me gjithë sistemin dhe synimet tona, që kemi dashur t'i arrijmë në këtë drejtim. E para, të gjitha propozimet që kanë ardhur nga shoqëria civile, qoftë nga ekspertë, qoftë nga ekspertë të prokurorisë apo gjykatave. Është kërkuar modaliteti më i mirë për të ngritur efikasitetin e gjyqësorit në vend.

E fillova me këtë sepse desha të ndërlidhem me kërkesën e juaj si zyrë e prokurorit disiplinor, e para duhet të ndahen qartë hetimet penale dhe disiplinore dhe mos të krijohet konfuzion në shoqërinë tonë, se ne me shkurtimin e afatit kemi parandaluar hetime penale për njerëz që mund të bien ndesh me ligjin që janë brenda sistemit të drejtësisë, qoftë gjyqtarë, qoftë prokurorë. Ndërsa sa i përket hetimeve disiplinore kemi pas si qëllim të rrisim efikasitetin e zyrës tuaj, duke shkurtuar afatet dhe njerëzit mos të mbesin peng të hetimeve disiplinore. Çdo vit që janë duke u hetuar gjyqtarë dhe prokurorë, mirëpo, ne nuk kemi asnjë rezultat deri me sot. E them këtë për arsye se po t'i marrim raportet apo deklaratat, e shohim se numri i hetimeve është i njëjtë, kurse janë disa raste të caktuara që pastaj të atakohet Komisioni i ligjeve për një mospunë që është bërë në institucionet e drejtësisë. Dikush ka përvojë më të gjatë dhe e ka përcjell sistemin e drejtësisë në vend dhe ndër qëllimet tona kanë qenë të shkurtohen afatet, pra të ngritet efikasiteti i zyrës tuaj, të ndahet përgjegjësia penale dhe ajo disiplinore. Ne i dimë edhe sfidat, nuk është faji te individë të caktuar por është faji i sistemit dhe ne do të ndikojmë që ta ndërrojmë këtë sistem, me i largu njerëzit që janë të korruptuar, dhe nuk është faji vetëm te afatet por është te puna dhe përgjegjësia. Një rast që e shohin i gjithë opinion, a duhet të pres prokuroria apo policia për afate? Jo, por këtu është mospërgjegjësia .

Selviqe Halimi – Në takimin që kishim me z. Prendrecaj u dakordua që të na sillen me shkrim propozimet ku ata mendojnë se duhen të bëhen plotësim- ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial. Tani që i kemi këto propozime, duhet të shikohet nëse ka nevojë për ndryshime në këto ligje apo duhet të mbetet që të rritet efikasiteti i punës së kësaj zyre. Jemi munduar ta ndihmojmë sistemin e drejtësisë. Ne si Komision kemi punuar me të vërtetë dhe jemi atakuar si Komision në formë të ndryshme dhe pse në sallën ku kemi punuar kanë qenë prezent shoqëria civile, përfaqësues të institucioneve dhe anëtarë të ndryshëm të Komisioneve tjera parlamentare. Prandaj, propozoj që këto propozime t'i shqyrtojmë edhe njëherë dhe të shikohet se a duhet të punohet në ndryshimet për këto dy ligje, apo duhet të rritet efikasiteti i punës së kësaj zyre. Sa i përket dispozitave kalimtare, nuk besoj që një dispozitë kalimtare mund të shkaktojë problem në zbatim .

Kryetarja –U përmenden shumë skandale të sistemit të drejtësisë. Atëherë në mbledhje të Komisionit do të ftojme z. Peci, kryetar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës të na informojë se çka po ndodhë. Ai na ka sjellë një raport të punës si njoftim, por ne patjetër do ta ftojme edhe të raportojë në Komision. Gjithashtu, prapë do të ndërlidhem me temën, duke pyetur z. Prendrecaj se a ka pas buxhet dhe staf të mjaftueshëm dhe sa ka qenë dënimi më i lartë që ju si zyrë e keni dhënë, pra me shifra na intereson të dimë se ku qëndron problemi dhe a është i gjithë problemi në këto dispozita kalimtare ?

Zef Prendrecaj - Edhe një here desha të theksoj pse jam unë sot këtu. Edhe njëherë dua ta cekë se zyra jonë ka të bëjë vetëm me hetime disiplinore, por që ndoshta opinionin ndonjëherë mund të mos jetë mirë i informuar për arsye se ne nuk njoftojmë derisa të kryhen ato hetime. Me bindje të plotë mund t'ju them që nuk jemi ankuar në punën që është kryer nga Komisioni juaj, përkundrazi, jemi mirënjohës për veprimet e ndërruara, ne si zyrë vetëm kemi kërkuar nga ju që ti ndërroni këto dispozita nëse doni që sistemi Prokurorial e Gjyqësor të funksionojë si duhet.

Armend Zemaj- Nuk po ju atakojmë juve apo raportin e punës tuaj, por ne po ju tregojmë se i kemi marrë parasysh gjitha rekomandimet dhe jemi mundu me nxjerr një produktin më të mirë. Pra na kemi dashtë të rriten kapacitetet e zyrës tuaj nga katër inspektorë të bëhen më shumë, sepse e dimë që numri i prokurorëve dhe gjyqtarëve është rritur. Krejt çka kam kërkuar është të ndahen çështjet, që janë të ndara edhe me ligj, të shihen qartë përgjegjësitë e zyrës tuaj.

Kryetarja tha se është e befasuar nga shoqëria civile p.sh Instituti i Kosovës për Drejtësi, që shpesh e ndihmon Komisionin, ka qenë edhe prezent gjatë punës dhe në fund del me reagime ndaj Komisionit, ndërsa gjatë punës që është zhvilluar nuk kanë reaguar fare. Po e shoh një gatishmëri të Komisionit për formimin e grupit punues dhe të ky grup do të analizojë dhe punojë në këto plotësime dhe ndryshime.

Pas diskutimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Formohet grupi punues për shqyrtimin e shkresës së Zyrës së Prokurorit Disiplinor, që ka të bëjë me Ligjin nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në përbërje :

- Armend Zemaj, kryesues
- Albulena Haxhiu, anëtare
- Selvije Halimi, anëtare
- Danush Ademi, anëtar

4. Diskutim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik;

Kryetarja informoi Komisionin se pas dëgjimit publik që është organizuar së bashku me grupin për studime juridike dhe politike, ka pasur një mendim që ky projektligj ti kthehet Qeverisë për arsye se nuk i adreson problemet me të cilat po ballafaqohemi.

Si kryetare e Komisionit, tha ajo, mbështes fuqishëm kthimin e projektligjit dhe jam munduar të kem takim edhe me ministrin e Drejtësisë, por takimi ka qenë i pamundur.

Gjithashtu e informoi Komisionin se kthimin e këtij projektligji në Qeveri e kanë përkrahur edhe Zyra e BE-së në Kosovë, Grupi për Studime Politike dhe Juridike, Instituti GAP dhe ÇOHU. Kryetarja propozoi që Komisioni ti rekomandojë Kuvendit që ky Projektligj të mos miratohet, pra ti kthehet Qeverisë.

Armend Zemaj – Ne kemi pasur një grup punues që ka punuar dhe ne nuk kemi qenë të kënaqur me këtë Projektligj, por kemi bërë amendamente dhe mendoj që është kompletuar mjaft mirë Projektligji.

Zemaj ishte i mendimit që kthimi i Projektligjit do të ndikojë që të zgjatet procedura, dhe shtoi se më mirë është të formohet grupi punues dhe ti bëjë amendamentet, kjo do të ishte rruga më e mire dhe më e shkurtër.

Kryetarja theksoi se ky Projektligj ende nuk është votuar në parim, në fakt është votuar herën e parë, kur e ka sjellë Qeveria e më pas është tërheq, më duket nga zëvendëskryeministri Kujtim Shala. Kam menduar se do ta sjellin një Projektligj ku do të adresohen problemet, por ata kanë sjell një Projektligj edhe më të keq. Dy nene të këtij projektligji janë punuar nga këshilltari i Kryeministrit, dhe vlerësoi se projektligjet nuk jemi duke i punuar për interesa politike. Pra, unë kam pyetur edhe ministrin e Drejtësisë, se në hartim a ka marrë pjesë edhe këshilltari. Na është thënë se nuk mund të përmendim emra të përvetshëm. Gjithashtu edhe Agjencia Kundër korrupsionit është i mendimit që ti kthehet Qeverisë, pra unë mendoj se duhet ti kthehet Qeverisë ky Projektligj.

Armend Zemaj theksoi se nuk mund të themi pa qenë prezent se një këshilltar ka marrë pjesë në hartim të një Projektligjit, këto janë vetëm dyshime tuajat kryetare. Unë nuk mund të flas për diçka që nuk kam qenë prezent dhe jam i mendimit që Projektligji të procedohet në seancë plenare dhe të diskutojmë. Jemi prapë ata deputetë që kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar për të njëjtën çështje.

Donika Kadaj Bujupi theksoi se edhe pas punës që do ta kryej Komisioni, Qeveria prapë do ta tërheq këtë projektligj pa asnjë sqarim si herën e kaluar. Po me duket si një lloj shakaje me ne, po tërhiqet pa asnjë sqarim, pa asnjë shkresë dhe pa asnjë arsyetim.

Selvije Halimi –Propozoj që Projektligji të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend dhe më pas të formohet një grup punues që do të merret me amendamentimin e tij. I këtij mendimi ishte edhe deputeti **Agim Ademaj**.

Meqë kishte mospajtime rreth procedimit të Projektligjit, për shqyrtim në parim, kryetarja hodhi në votim propozimin e deputetit Armend Zemaj, ku me 5 vota “për” dhe dy “kundër” Komisioni vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik.

5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;

Komisioni, e shqyrtoi propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e anëtarit është në përputhje me nenin 3.3 të ligjit nr. 02/L-25, për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Prandaj duke marrë parasysh bazën ligjore të propozuesit i përcaktuar me ligj dhe obligimin e Kuvendit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, Komisioni me 6 vota “për” dhe 2 “kundër”, vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidati:

- I. Elbasan Dervishaj, anëtar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
- II. Mandati anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjatë 2 (dy) vite

6. Të ndryshme.

Kryetarja e njoftoi Komisionin se i ka bërë ftesë znj. Edita Tahiri që të vijë në mbledhjen e Komisionit për të raportuar lidhur me bazën kushtetuese dhe ligjore të marrëveshjeve arritura me Serbinë.

Selvije Halimi tha se ne si Komision, në fillim të sesionit të kaluar patëm diskutuar që kur të ftojmë zyrtarë në Komision, të merr vendim komisioni, e njëjta vlen edhe kur adresojmë kërkesa në adresë të institucioneve të caktuara dhe jo kështu siç keni vepruar ju si kryetare.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi